



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 22.05.2025
Numër Protokoli: 3744/2025

A.nr.616/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.616/2025, të datës 08.04.2025, të parashtruar nga ankuesi J.K, kundër organit të punësimit/Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 22.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.616/2025, të datës 08.04.2025, të parashtruar nga ankuesi J.K.

A r s y e t i m

Ankuesi, J.K.(*në tekstin e mëtejme referuar* Ankuesja), më datë 08.04.2025 përmes emailit ankesa.kpmsheck@rks-gobv.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër anulimit të konkursit me Nr. Referencës: RN00015558 për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, respektivisht për pozitën e punës “*Inspektor i Tregut*”, të shpallur nga Ministria e Industrisë, Tregtisë dhe Ndërmarrësisë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosien e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.616/2025, sepse: Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, më datë 21.10.2024, ka shpallë konkursin publik me numër reference RN00015558, grupi i administrimit të përgjithshëm, pozita:

Inspektor i Tregut, klasa Profesional 1, shtatë vende pune, më afat të aplikimit 22.10.2024 deri më datë 20.11.2024.

Tutje sipas provave materiale të çështjes del se në konkursin përkatës ka aplikuar edhe ankuesi I cili ka marr pjesë në të gjitha fazat e procedurës, ndërsa Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ndërmarrësisë, Industrisë dhe Tregtisë, më datë 17.01.2025, ka publikuar Njoftimit me numër protokolli Nr.prot166/03, nga i cili njoftim rezulton se si kandidatë me më së shumti pikë për pozitën përkatëse janë shpallur, J.K me 79.6 pikë, A.U me 78.6 pikë, I.B me 75 pikë, V.Th-S me 74.8 pikë, M.B me 73.4 pikë, K.Xh me 72.4 pikë dhe J.K me 72.4 pikë.

Bazuar në të dhënat e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, rezulton se kandidati V.D, si kandidatë aplikues në procedurën e rekrutimit me numër reference RN00015558, më datë 27.01.2025 kishte parashtruar ankesë në Këshill, kundër procedurës së njëjtë, ndërsa, Këshilli me Vendimin me numër A.nr.213/2025, të datës 17.03.2025, ka anuluar Konkursin me numër reference RN00015558, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, gjegjësisht pozitën “Inspektor i Tregut” në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, si dhe çdo veprim tjetër që ka rrjedhë nga kjo procedurë e rekrutimit.

Andaj, referuar gjendjes se fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.616/2025, të datës 08.04.2025, ka të bëjë me procedurën e pranimit për të cilën Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.213/2025, të datës 17.03.2025, rrjedhimisht ka anuluar në tërësi procedurën e pranimit me numër reference RN00015558, atëherë mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”*. Kolegji vlerëson së objekti i ankesës A.nr.616/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.616/2025, të datës 08.04.2025.

Këshillë juridike: *Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.616/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit J.K;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MINT; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.